



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.58

23 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.338, datë 19.3.2008	Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike	2567
Vendim i KM nr.407, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qafë Mali të qarkut të Shkodrës.....	2590
Vendim i KM nr.408, datë 4.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Rrape të qarkut të Shkodrës.....	2592
Vendimi KM nr.409, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Vau i Dejës të qarkut të Shkodrës.....	2593
Vendim i KM nr.410, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Zharrëz të qarkut të Fierit.....	2594
Vendim i KM nr.411, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Aranitas të qarkut të Fierit.....	2595
Vendim i KM nr.412, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Lekas të qarkut të Korçës.....	2596
Vendim i KM nr.413, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gorë të qarkut të Korçës	2597

Vendim i KM nr.414, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Libonik të qarkut të Korçës	2598
Vendim i KM nr.415, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Çepan të qarkut të Beratit.....	2599
Vendim i KM nr.416, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Roshnik të qarkut të Beratit.....	2599
Vendim i KM nr.417, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Vertop të qarkut të Beratit.....	2601

VENDIM
Nr.338, datë 19.3.2008

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.628, datë 3.10.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË NË ZBATIM TË VKM NR.201, DATË 29.3.2006 (VERSIONI SIPAS PIKËS 4.1)

1. Projektakti synon të transpozojë dispozitat e legjislacionit të BE-së të evidentuara, si të detyrueshme në Direktivën 2003/54/EC botuar në Fletoren Zyrtare. Ai ekzekuton dispozitat e direktivës së sipërcituar përse i takon përcaktimit të rregullave të funksionimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike”				
2-Për miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike				
3-Përafrim i pjesshëm i Direktivës 2003/54 (KE), nëpërmjet transpozimit të përmbajtjes së parimeve dhe neneve të kësaj direktive				
a	b	c	d	e
Në direktivën 2003/54	1.Në Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, pjesë e projektvendimit “Për miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike	Përafrim i pjesshëm		
Neni 8 dhe neni 9, Qëllimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe detyrat që kryen përcakton detyrat e OST ku jep se ky operator duhet të kryejë transmetimin e energjisë elektrike, përputhjen e kërkesës me furnizimin, menaxhimin e flukseve të energjisë, pra dispeçimin e tyre, si dhe operatorin e tregut, si dhe zhvillimin e rrjetit të	4.1 OST-ja është shoqëri e pavarur shtetërore që kryen këto funksione: operimin e rrjetit nga pikëpamja fizike (posedim, mirëmbajtje dhe zgjerim) (ORT); Operatorin e Sistemit nga pikëpamja e dispeçerimit (OS); Operatorin e Tregut (duke siguruar që informacioni për likuidimin e kontratave është i disponueshëm, që më pas mund të shërbejë si një bursë e energjisë elektrike).			

<p>transmetimit.</p> <p>Neni 2, pika 8, jepet definicioni për Furnizuesit me shumicë.</p> <p>Neni 13-Qëllimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që përcakton se OSSH është përgjegjës për shpërndarjen e energjisë elektrike, të sigurojë mirëmbajtjen e rrjetit që disponon, zhvillon dhe mirëmban rrjetin shpërndarës.</p> <p>Neni 23, pika 1 Autoriteti Rregullator Që përcakton se ai është një strukturë e pavarur nga interesat e industrisë elektrike dhe është përgjegjës për funksionimin e tregut duke siguruar jo diskriminimin, efektivitetin dhe kompeticion</p> <p>Neni 9 (a) Detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ku përcaktohet se: OST siguron aftësinë e sistemit për të mbajtur kapacitetet e sistemit të transmetimit në përputhje me</p>	<p>4.7 Furnizuesi Publik me Shumicë ka përgjegjësi për blerjen e energjisë elektrike për furnizimin pa ndërprerje të klientëve tariforë. Furnizuesi Publik ka përgjegjësinë si furnizues publik që të shërbejë si sigures i alternativës së fundi për të gjithë klientët.</p> <p>4.7 Furnizuesi Publik me Shumicë ka përgjegjësi për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar furnizim të majftueshëm për Furnizuesin Publik me Pakicë sipas kërkesës së këtij të fundit për furnizimin pa ndërprerje të Klientëve Tariforë.</p> <p>4.8 OSSH-ja zotëron, mirëmban, zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes në të gjithë Shqipërinë.</p> <p>OSSH-ja do të përdorë të njëjtën metodologji për të llogaritur tarifën e përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes që ajo përdor për llogaritjen e tarifave për klientët tariforë.</p> <p>OSSH/Furnizuesi Publik do t'ia propozojë të ndarë ERE-s tarifën e shërbimit të shpërndarjes nga tarifat e furnizimit të klientëve tariforë.</p> <p>4.12-Rregullatori i Pavarur (ERE) ERE-ja është përgjegjëse: a) për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve respektive të pjesëmarrësve të tregut sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jo diskriminuese që sigurojnë aksesin e palëve të treta; (Që është në vartësi të Kuvendit përcaktohet në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e Energjisë elektrike”.</p> <p>5.1 Parashikimi afatgjatë OST-ja ka për detyrë të përgatisë parashikime 15-vjeçare për nevojat e vendit për energji elektrike</p>			
--	--	--	--	--

<p>kërkesën afatgjatë</p> <p>Neni 12- Konfidencialiteti në Operatorin e Sistemit të Transmetimit përcakton se OST duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit dhe të punojë në mënyrë jodiskriminuese</p> <p>Neni 11-Dispeçimi dhe balancimi përcakton se furnizimi elektrikitetit bëhet në bazë të detyrimeve kontraktuale</p> <p>OST ka detyrë të kryejë dispecimin e instalimeve gjeneruese dhe të përdorë interkonjeksionin sipas kriterëve të përcaktuara</p> <p>Neni 9 (c) te detyrat e OST përcaktohet se OST ka detyrë të menaxhojë flukset e energjisë në sistem duke llogaritur dhe shkëmbimet me interkonjeksionin është përgjegjës për të garantuar siguri të furnizimit dhe</p> <p>Neni 23.2 (a) Autoriteti Rregullator. Përcakton se ai është përgjegjës për përcaktimin e metodologjisë dhe tarifave në rrjetin nacional</p> <p>Tarifat dhe metodologjitë duhet të lejojnë investimet e nevojshme për të garantuar punë të sigurt të rrjetit</p> <p>Neni 23.1 Autoriteti Rregullator</p> <p>Që përcakton se ai është një</p>	<p>OST-ja është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit të siguruar nga pjesëtarët e tregut në ato raste kur nxjerrja e tij dëmton konkurrencën.</p> <p>5.2 Kontrata e furnizimit të një viti në avancë Marrëdhëniet dhe roli i pjesëmarrësve të tregut me operimin fizik të Modelit të Tregut bazohet në kontrata dypalëshe mes pjesëmarrësve të ndryshëm në përputhje me përcaktimet e mëposhtme. OST-ja blen nëpërmjet kontratës së shërbimeve ndihmëse, shërbimet që i nevojiten sistemit në përputhje me parashikimet që i dërgohen asaj nga OSSH-ja, furnizuesi publik dhe Klientët e Kualifikuar. OST-ja ka përgjegjësinë të dispeçerojë të gjitha njësitë në zotërim të KESH Gen-it, të PPE-ve, Tregtuesve dhe Furnizuesve të Kualifikuar dhe të respektojë të gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara në rregullat e tregut</p> <p>5.6 OST-ja do të krahasojë shumën e parashikimeve të ngarkesës të marrë nga pjesëtarët e tregut me parashikimet e saj dhe të vendosë së çfarë hapash të mëtejshëm (p.sh. blerje mund të jenë të nevojshme për të balancuar sistemin</p> <p>7.Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i siguron shërbimin e shpërndarjes klientëve të kualifikuar sipas tarifave të përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes të miratuara nga ERE-ja.</p> <p>8.Roli i Rregullatorit të Pavarur ERE</p> <p>ERE-ja e ushtron veprimtarinë e saj në</p>			
--	--	--	--	--

<p>strukturë e pavarur nga interesat e industrisë elektrike dhe është përgjegjës për funksionimin e tregut duke siguruar jo diskriminimin efektivitetit dhe kompeticionin</p> <p>Neni 20. Aksesit i Palëve të Treta përcakton se duhet siguruar aksesit i Palëve të Treta në transmetim në mënyrë jodiskriminuese</p> <p>Neni 23 b Përcakton se duhet të ketë mekanizma në rastet e transmetimeve të ngarkesave shumë të mëdha dhe të linjave të mbingarkuara</p> <p>Neni 23.1.d përcakton se duhet të publikohen informacione lidhur me kapacitetet në transmetim dhe shpërndarje, por pa shkelur parimet e konfidencialitetit</p> <p>Neni 11-Dispeçimi dhe balancimi përcakton se furnizimi i elektricitetit bëhet në bazë të detyrimeve kontaktuale</p> <p>23.2.b Përcakton se duhet të parashikohet shërbimi i blancimit dhe 23.3 përcakton se duhet të përcaktohen rregulla, metodologji dhe tarifa për këtë qëllim</p>	<p>bazë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” me të gjitha ndryshimet. Funksionimi i rregullatorit të pavarur përmbush kërkesat e Direktivës së BE-së 2003/54</p> <p>8.b-Aksesit i Palëve të Treta. Prioriteti në sistemin e transmetimit ose e menaxhimit të bllokimeve kur linjat e transmetimit janë të kufizuara dhe nuk mund t’i përballojnë të gjitha kërkesat e Klientëve Tariforë dhe atyre të Kualifikuar. Një çështje tjetër që duhet trajtuar në Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut është ajo se si do të ndahet mungesa e kapaciteteve mes Klientëve Tariforë dhe Klientëve të Kualifikuar në mënyrë që të zbatohet nga OST-ja. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimet e aksesit të hapur dhe jodiskriminues.</p> <p>8.d Në mënyrë që tregu të arrijë objektivat e tij, ERE-ja dhe në shumë raste OST-ja, duhet të kenë akses të mjaftueshëm në informacionin lidhur me operimet, kostot, si dhe termat dhe kushtet e kontratave ndërmjet palëve.</p> <p>8.h. Shërbimi i Disbalancës së Energjisë sigurohet kur ka një diferencë ndërmjet sasisë së prodhimit që është programuar një ditë më parë ose që është prodhuar në kohë reale dhe të konsumit (ngarkesës) në kohë reale.</p>			
--	--	--	--	--

MODELI SHQIPTAR I TREGUT

HYRJE

Miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, përben një nga hapat e rëndësishëm drejt konsolidimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri.

Ky miratim është pjesë e reformës që ka ndërmarrë Qeveria Shqiptare për ristrukturimin e gjithë sektorit elektroenergjetik, mbështetur në ligjin për sektorin e energjisë elektrike, si dhe në politikat e Qeverisë për zhvillimin e këtij sektori.

Gjithashtu, Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike është hartuar në zbatim të Direktivave të Bashkimit Europian për energjinë elektrike, si dhe të kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të vendeve të Europës Juglindore, për krijimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike, dokument ky i ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2006.

Struktura e mëparshme e quajtur Modeli Tranzitor i Tregut të Energjisë Elektrike gjatë procesit të zbatimit në praktikë, evidentoi nevojën e përditësimit të tij, në funksion të zhvillimeve që lidhen me thellimin e reformës në sektorin elektroenergjetik shqiptar të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare.

Struktura e re e quajtur Modeli Shqiptar i Tregut të Energjisë Elektrike, parashikon zhvillimin mbi baza me të konsoliduara të tregut të energjisë elektrike dhe përputhshmëri më të plotë me Direktivat e Bashkimit Europian dhe parashikohet të ketë një qëndrueshmëri me të gjatë se faza tranzitore që parashikonte modeli i mëparshëm.

Modeli i Tregut i paraqitur merr në konsideratë:

- Hapat që ka ndërmarrë Qeveria nga struktura vertikalisht e integruar e sektorit elektroenergjetik, drejt ndarjes së veprimtarive në shoqëri gjenerimi, transmetimi dhe shpërndarje, ligjerisht, funksionalisht dhe financiarisht të ndara.

- Objektivin politik të Qeverisë për fillimin e procesit të privatizimit në sektorin elektroenergjetik shqiptar.

- Përshtatjen e legjislacionit të energjisë elektrike me ato të Bashkimit Europian.

- Zhvillimin e tregut të energjisë elektrike mbështetur në rregulla tregu dhe në kode të rrjetit të qarta, si kërkesa minimale teknike për një operim eficient të sistemit elektroenergjetik.

- Përfitimet sa më të mëdha për klientët në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe shërbim cilësor e të qëndrueshëm.

- Vendosjen e aksesit për palët e treta, për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike, si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e një tregu transparent dhe jo-diskriminues të energjisë elektrike.

- Liberalizimin e tregut të energjisë elektrike duke krijuar një strukturë tregu që rrit interesin dhe numrin e pjesëmarrësve në të.

- Monitorimin e tregut të energjisë elektrike nga ERE, si një institucion i pavarur me autoritetin për të miratuar gjithë legjislacionin e nevojshëm sekondar për këto qëllime.

- Rregullat për kryerjen e transaksioneve në treg që janë transparente dhe jo-diskriminuese dhe që shmangin devijimet e mundshme të fondeve.

- Zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve dhe njëkohësisht për rritjen e efikasitetit të sistemit elektroenergjetik shqiptar.

- Integrimin e tregut të energjisë elektrike të vendit në tregun Rajonal dhe me vone në Tregun Europian të Energjisë Elektrike.

Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike mund të jetë objekt përditësimi në funksion të zhvillimeve që do të ketë sektori elektroenergjetik shqiptar dhe angazhimeve që vendi ynë mund të marrë në kuadrin e bashkëpunimit rajonal.

1. Qellimi dhe objekti

1.1 Synimi i Modelit të Tregut

- Te krijoje kushte per te shkuar drejt nje tregu te konsoliduar.
- Te siguroje fluks fondesh dhe llogarish transparente dhe eficente.
- Te lejoje tregtim te energjise elektrike, import dhe eksport, te orjentuara nga tregu, duke ruajtur perfitimet per Klientet.

1.2 Kerkesat qe Modeli i Tregut te funksionojë ne mënyrë efektive

- Te egzistojne llogari transparente per tregun e rregulluar, si dhe per operatorët e rrjeteve te transmetimit dhe shperndarjes.
- Te kete mbikqyrje rregullatore nga ERE.
- Te kete struktura te monitorimit te tregut dhe te raportimit te te dhenave.
- Rregullat e tregut dhe kodet perkatese te jene fleksibel dhe njekohesisht te mbrojne ne mënyrë efektive nga çdo mundesi abuzimi dhe praktikash te pandershme tregtare.

1.3 Synime te tjera me rendesi te Modelit të Tregut

- Te marrë ne konsiderate shnderrimin e KESH-it nga nje shoqeri vertikalisht e integruar ne nje strukturë me entitete te ndara ligjerisht, financiarisht dhe funksionalisht.
- Te krijoje strukturën e nevojshme qe konkurenca te zhvillohet si ne tregun e shitjes me shumice ashtu edhe per Klientet e Kualifikuar.
- Te krijoje strukturën e nevojshme ligjore dhe rregullatore per privatizimin e industrise elektroenergjitike, duke filluar me sektorin e Shperndarjes.
- Te zbatoje politiken e qeverise per krijimin e nje Operatori Sistemi Transmetimi (OST) te pavarur dhe per te rritur transparencen ne operimin dhe funksionimin e tregut.
- Te percaktoje pergjegjesite e Furnizuesit Publik me shumice per menaxhimin e risqeve hidrologjike te hidrocentraleve me objektiv per te minimizuar kostot e furnizimit te Furnizuesit Publik me Pakice ne perfitim te Klienteve Tarifore.

2. Percaktimet

Termet dhe shkurtimet e perdorura ne kete dokument kane kuptimin e meposhtem:

- **“Tregu i energjise elektrike”** eshte shkembimi i kerkeses dhe ofertes per blerjen, shitjen dhe furnizimin e energjise elektrike.
- **“ERE”** do te thote Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike, baza ligjore per ushtrimin e pergjegjesive te te cilit pecaktohet nga ligji nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, i ndryshuar.
- **“Rregulla Tregu”** do te thote teresia e rregullave te miratuara nga ERE qe percaktojne procedurat per operimin dhe menaxhimin e tregut, si dhe marrëdhëniet ndermjet pjesmarrësve te tregut.
- **“Sistemi elektroenergjetik”** eshte nje sistem i nderlidhur i perbere nga centralet e prodhimit te energjise elektrike, linjat, nenstacionet dhe paisjet per transmetimin dhe shperndarjen e energjise elektrike tek konsumatorët.
- **“Sherbime ndihmese”** jane te gjitha sherbimet e nevojshme per operimin e sistemit te transmetimit dhe te shperndarjes;
- **“KESH”** do te thote Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.
- **“OST”** do te thote Operatori i Sistemit te Transmetimit.
- **“KESH Gen”** do te thote nje strukture brenda KESH-it me license per prodhimin e energjise elektrike.
- **“Furnizues Publik me Shumice”** eshte nje strukture brenda KESH-it e ndare funksionalisht dhe financiarisht, me license per blerjen e energjise elektrike nga KESH Gen-i, PPE-te, PVE-te, apo treguesit, me qellim shitjen tek Furnizuesi Publik me Pakice.
- **“Shoqeria e Shperndarjes”** do te thote shoqeria me license per kryerjen e funksioneve te

Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të furnizimit publik me pakice.

- **“OSSH”** do të thotë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, që kryen funksionin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- **“Furnizuesi Publik me Pakice”** është një strukturë e organizuar brenda Shoqërisë së Shpërndarjes, e ndarë funksionalisht dhe financiarisht, me licencë për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike të Klienteve Tarifore.

- **“PVE”** do të thotë prodhues i vogël i energjisë elektrike i lidhur në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike.

- **“PPE”** do të thotë prodhues i pavarur i energjisë elektrike i lidhur në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

- **“Furnizues i Kualifikuar”** është një pjesëmarrës i tregut, i licensuar për të furnizuar me energji elektrike Klientët e Kualifikuar.

- **“Tregtues”** është person i licensuar që blen dhe shet energji elektrike, me përjashtim të shitjes tek furnizuesi publik me pakice dhe të klientet fundore.

- **“Blerje e energjisë ekonomike”** janë blerjet e energjisë elektrike nga KESH Gen-i, për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale.

- **“Klient Tarifor”** është një konsumator i energjisë elektrike që blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Pakice.

- **“Klient i Kualifikuar”** është konsumatori i energjisë elektrike që ka të drejtë të zgjedhë furnizuesin e tij, nga i cili blen energji elektrike për nevojat e veta.

- **“AKBN”** do të thotë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

- **“Kontrata dypaleshe”** janë marrëveshje që lidhin pjesëmarrës të ndryshëm të tregut në shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike, si dhe shërbimeve ndihmese.

- **“Fluksi i fondeve”** është shkëmbimi i vlerave monetare kundrejt shlyerjes së detyrimeve kontraktore ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

- **“Fluksi i energjisë elektrike”** është sasia e energjisë elektrike që kalon në rrjetat e transmetimit dhe të shpërndarjes.

3. Modeli i Tregut

3.1 Synimet dhe Objektivat:

Modeli Shqiptar i Tregut është dizenuar që të çojë përpara politikën e Qeverisë Shqiptare në fushat e mëposhtme:

i) Në krijimin e një kuadri për reformimin e sektorit elektroenergjetik, përfshirë privatizimin e funksioneve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice në një periudhë afat-shkurter. Ky kuader do të sigurojë një bazë të shëndoshe për privatizimin e segmenteve të tjera të sektorit elektroenergjetik.

ii) Në levizjen drejt përputhjes me Direktivat e BE-së dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

iii) Në vendosjen e kontratave dypaleshe me një treg të thjeshtë të rregulluar balancimi për transaksionet e energjisë, të cilat do të përmirësojnë transparencën dhe do të shmangin “mbivendosjen” e transaksioneve pa qenë të nevojshme.

iv) Në ruajtjen e vlerës së plotë të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve hidro në favor të klienteve tarifore shqiptare.

v) Në përmirësimin e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit elektroenergjetik duke qartësuar përgjegjësitë dhe detyrimet, si dhe duke siguruar flukse të mjaftueshme të informacionit lidhur me operimin e tregut dhe duke krijuar një strukturë të qartë për transaksionet e tregut elektroenergjetik.

vi) Ne sigurimin e perfitimeve per klientët.

Këto synime dhe objektiva jane ne përputhje dhe reflektojne gjithashtu zhvillimin e metejshem te synimeve dhe objektivave te parashtruara ne Seksionin A te Modelit Tranzitor te Tregut, qe është miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.539 date 12 gusht 2004. Mbas miratimit nga Qeveria, Modeli Shqiptar i Tregut do te zevendesoje Modelin Tranzitor te Tregut.

4. Pjesmarrësit dhe karakteristikat e Modelit te Tregut

Modeli i Tregut trajton gjithashtu pergjegjesite dhe marrëdhëniet ndermjet pjesmarrësve te tregut dhe te Entit Rregullator te Sektorit te Energjisë Elektrike (ERE).

Modeli Shqiptar i Tregut, ne kuptimin e gjere, karakterizohet nga kontrata dypaleshe te energjisë elektrike ndermjet pjesëmarrësve te tregut.

Shërbimet ndihmese per Sistemin e Transmetimit blihen nga OST-ja.

Rregullimi i çmimeve, termave dhe kushteve te tjera ne kuadrin e Modelit te Tregut është gjithperfhires. Ai reflekton situaten monopol ne te ardhmen e afert te KESH-Gen-it, OSSH-se, Furnizuesit Publik me Shumice, Furnizuesit Publik me Pakice dhe OST-se.

Te gjitha kontratat dhe tarifat ndermjet pjesmarrësve te ndryshem te tregut, do te jene te rregulluara, qe ne pikenisjen e tyre, me perjashtim te:

a) Kontratave respektive ndermjet, Treguesve dhe Furnizuesve te Kualifikuar nga njera ane dhe Furnizuesit Publik me Shumice dhe Klienteve te Kualifikuar nga ana tjeter.

b) Kontratave ndermjet PVE-ve, PPE-ve dhe Klienteve te Kualifikuar.

c) Kontratave ndermjet KESH-Gen-it nga njera ane dhe Furnizuesve te Kualifikuar dhe Treguesve, nga ana tjeter, ne masen qe lejohet nga kufizimet e tjera ndaj shitjeve te KESH-Gen-it.

d) Kontratave ndermjet PVE-ve, PPE-ve nga njera ane dhe tregtareve nga ana tjeter.

4.1 OST-ja

Është shoqeri e pavarur shteterore qe kryen këto funksione:

- Operimin e rrjetit te transmetimit nga pikpamja fizike (posedim, mirembajtje dhe zgjerim) (ORrT);

- Operatorin e Sistemit nga pikepamja e dispecerimit (OS);

- Operatorin e Tregut (duke siguruar qe informacioni per likuidimin e kontratave është i disponueshem, qe me pas mund te sherbeje si nje burse e energjisë elektrike).

OST-ja verifikon:

Informacionin ne se Furnizuesi Publik me Shumice dhe OSSH-ja i kane siguruar te gjitha burimet e mjaftueshme per te furnizuar Klientët tarifore dhe per te mbuluar humbjet ne shperndarje, sipas grafikeve te ngarkeses vit, muaj, jave dhe dite ne avance.

OST-ja ka autoritet:

T'i kerkoje Furnizuesit Publik me Shumice dhe OSSH-se qe te bejne blerje energjie ne përputhje me nevojat per energji te Furnizuesit Publik me Pakice per Klientet Tarifore dhe per humbjet ne sistemin e shperndarjes.

T'i kerkoje Klienteve te Kualifikuar te vertetojne se ata do te jene ne gjendje te sigurojne furnizimin e mjaftueshem per veten e tyre.

T'i kerkoje Furnizuesve te Kualifikuar te vertetojne se jane ne gjendje te sigurojne furnizimin e mjaftueshem me energji elektrike te Klienteve te Kualifikuar.

T'i kerkoje KESH Gen-it, PPE-ve, PVE-ve dhe ngarkesave te dispecerueshme informacion qe demonstron se ata kane kapacitetin ose ngarkesen qe te permbushin angazhimet e tyre.

OST-ja:

Parashikon dhe blen nga KESH Gen dhe pjesmarrësit e tjere te tregut, shërbime ndihmese sipas nevojës vit, muaj, dite ne avance dhe ne kohe reale.

Blen energji elektrike nga KESH Gen-i dhe pjesmarrësit e tjere te tregut, per te mbuluar humbjet ne sistemin e transmetimit.

Kompensohet per shërbimet nga pjesmarrësit qe i perfitojne ato, sipas tarifave te miratuara

nga ERE-ja.

4.2 Gjenerimi (KESH Gen)

I shet OST-se sherbime ndihmese dhe energji elektrike per te mbuluar humbjet teknike ne transmetim.

I shet Furnizuesit Publik me Shumice energji elektrike sipas kerkesave te tij me çmim te miratuar nga ERE-ja. Shitja behet sipas marrëveshjeve vjetore ose per periudha te tjera te miratuara nga ERE-ja.

I shet Furnizuesit Publik me Shumice energji elektrike shtese per te plotesuar kerkesat e klienteve tarifore me cmim te miratuar nga ERE-ja.

Shet energji te tepert ne tregun vendas ose ate te eksportit ne përputhje me rregullat dhe procedurat e shitjes se energjisë elektrike te miratuara nga ERE-ja.

Shkemben energji elektrike ne tregun e ekportit ne përputhje me rregullat e procedurat e shkembimit te miratuara nga ERE-ja ose sic mund te jete rene dakort nga autoritetet kompetente ne kuadrin e Traktatit te Komunitetit te Energjise ose marreveshje te tjera rajonale.

Ben blerje ekonomike te energjise elektrike, për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale.

Te gjitha perfitimet neto nga kapaciteti hidro vendas ruhen per klientët tarifore.

ERE-ja monitoron qe ky proces i shitjes dhe shkembimit te energjisë elektrike te jete ne përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga ERE-ja per shitjen dhe shkembimet e energjisë elektrike.

4.3 Prodhuesit e Vegjel te Energjise Elektrike (PVE)

Prodhues te vegjel jane centralet e vegjel gjenerues te energjise elektrike, qe lidhen ne sistemin e shpërndarjes.

PVE-te me license gjenerimi mund te shesin energji elektrike te Furnizuesit e Kualifikuar ose Tregtuesit ose OSSH, me terma te negociuara lirisht.

PVE-te mund te shesin energji elektrike te Furnizuesi Publik me Shumice me cmime te rregulluara.

ERE-ja percakton tarifa te thjeshta e te njehsuara te shitjes se energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjel ne tregun e rregulluar.

PVE-te mund te shesin energji elektrike tek OST-ja -ja per te mbuluar humbjet e energjise sipas kontratave te miratuara nga ERE-ja.

Nje PVE mund te aplikojte per licensen e Furnizuesit te Kualifikuar nese zgjedh t'i shese direkt energji Klienteve te Kualifikuar.

4.4 Prodhuesit e Pavaruar te Energjisë Elektrike (PPE)

PPE-te jane prodhuesit e pavaruar qe lidhen direkt ne sistemin e transmetimit.

PPE-te licensohen nga ERE-ja dhe mund te shesin kapacitete ose energji OST-se dhe OSSH-se, per te mbuluar humbjet ne sistemin e transmetimit dhe shperndarjes, Klienteve te Kualifikuar, Furnizuesve te Kualifikuar ose Tregtareve me cmime tregu ose Furnizuesit Publik me Shumice me çmim te rregulluar dhe kontrate te miratuar nga ERE-ja.

Nje PPE mund te aplikojte per license te Furnizuesit te Kualifikuar nese ai zgjedh t'i shese direkt Klienteve te Kualifikuar.

4.5 Furnizuesit e Kualifikuar (FK)

Furnizues te Kualifikuar jane:

Furnizuesit vendas ose te huaj te licensuar nga ERE-ja, te cilet mund te blejne energji nga tregtuesit, nga PVE-te ose nga PPE-te per t'juaj shitur Klienteve te Kualifikuar. Furnizuesit e Kualifikuar mund t'u shesin energji edhe Furnizuesit Publik me Shumice, Tregtuesve ose Furnizuesve te Kualifikuar te tjere.

PVE-te dhe PPE-te duhet te licensohen qe te behen Furnizues te Kualifikuar, nese ata vendosin qe t'i shesin direkt energji elektrike Klienteve te Kualifikuar.

Furnizuesit e Kualifikuar kane detyrimin t'i demostrojne OST-se qe ato kane kapacitet dhe energji te mjaftueshme per te permbushur kerkesat e Klienteve te tyre te Kualifikuar.

4.6 Tregtuesit

Tregtuesi eshte person i licensuar qe blen dhe shet energji elektrike, me perjashtim te shitjes tek furnizuesi publik me pakice dhe te klientet fundore.

Jane subjekte private vendase ose te huaja, qe blejne dhe shesin energji elektrike me shumice.

Tregtuesit licensohen nga ERE-ja.

Tregtuesit mund te blejne energji nga KESH Gen (per surpluset), PVE-te dhe PPE-te, per t'ja shitur Furnizuesve te Kualifikuar, Furnizuesit Publik me Shumice ose OSSH-se (per humbjet).

PPE-te ose PVE-te kur i shesin energji elektrike vetem Furnizuesit Publik me Shumice ose Furnizuesit e Kualifikuar paisen vetem me license prodhimi dhe jo me license tregtimi.

PPE-te, PVE-te ose Furnizuesit e Kualifikuar duhet te kene license tregtimi qe te jene tregtues.

ERE-ja do te siguroje qe licensat dhe procedurat e licensimit per Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit jane te thjeshta, jo-diskriminuese dhe nuk krijojne pengesa te panevojshme per hyrjen e Tregtuesve ne tregun shqiptar, si dhe jane subjekt i marreveshjeve te reciprocitetit. Kerkesat e licensimit do te detyrojne Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit t'i sigurojne ERE-s informacion lidhur me veprimtarite e tyre dhe aftesite e tyre teknike dhe financiare, si dhe se Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit zbatojne te gjitha rregullat e aplikueshme te tregut dhe kodet e rregullat.

4.7 Furnizuesi Publik me Shumice

Furnizuesi Publik me Shumice ka pergjegjesi per blerjen e energjisë elektrike, per te siguruar furnizim te mjaftueshem per Furnizuesin Publik me Pakice sipas kerkeses se ketij te fundit per furnizimin pa nderprerje te Klienteve Tarifore.

Furnizuesi Publik me Shumice ka pergjegjesine qe te sherbeje si sigures i alternatives se fundit per te gjithë klientët.

Furnizuesi Publik me Shumice ka pergjegjesine t'i vertetoje OST-se se ka siguruar furnizim te mjaftueshem me energji per te plotesuar kerkesen e Furnizuesit Publik me Pakice.

Furnizuesi Publik me Shumice ka te drejten te bleje nga KESH Gen-i te gjithë energji elektrike te prodhuar prej tij nga burimet hidro dhe burimet e tjera gjeneruese, dhe nga PPE-te, PVE-te, Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit per te permbushur detyrimet e tij ndaj Furnizuesit Publik me Pakice, qe t'u sherbeje te gjithë Klienteve Tarifore.

Marreveshja ndermjet KESH Gen-it dhe Furnizuesit Publik me Shumice duhet te reflektoje optimizimin e duhur te prodhimit te KESH Gen-it me synim minimizimin e koston totale te furnizimit qe i ngarkohet Furnizuesit Publik me Pakice dhe qe i kalohet Klienteve Tarifore.

Furnizuesi Publik me Shumice ka te drejte te mbuloje, nepermjet kontrates se tij me Furnizuesin Publik me Pakice, te gjitha koston e realizuara per blerjen e energjise, perfshire koston e energjise elektrike te importuar si dhe koston e blerjeve nga KESH Gen-i, PPE-te, PVE-te, Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesit.

Furnizuesit Publik me Shumice i kerkohet te siguroje te gjitha furnizimet e disponueshme, perfshire importet, per te shmanguar kufizimin e ngarkeses. Furnizuesi Publik me Shumice, me miratimin e ERE-s, mund te refuzoje blerjen e energjise elektrike kur kostoja e furnizimit kalon vleren e koston se mosfurnizimit te percaktuar nga ERE-ja ne përputhje me politiken e qeverise dhe ne konsultim me Keshillin e Ministrave.

4.8 Operatori i Sistemit te Shpërndarjes (OSSH)

OSSH-ja zoteron, miremban, zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes ne te gjithë Shqiperine.

OSSH-ja eshte pergjegjese per blerjen e energjise elektrike per te mbuluar te gjitha humbjet ne sistemin e shperndarjes. OSSH-ja mund ta bleje kete energji nga cdo pjesmarres tregu me cmime tregu.

OSSH-ja i siguron shërbim lidhjeje dhe shperndarjeje Klienteve Tarifore, PVE-ve dhe Klienteve te Kualifikuar te lidhur ne shperndarje, mbi baza jo diskriminuese.

Tarifat, termat dhe kushtet e shërbimeve te shpërndarjes qe sigurohen nga OSSH-ja rregullohen nga ERE-ja.

OSSH-ja eshte pergjegjese per reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike ne sistemin e shperndarjes, sipas kushteve te percaktuara nga ERE-ja. ERE-ja mund te percaktoje per OSSH-ne

nje tarife qe siguron incentiva per reduktimin e ketyre humbjeve.

4.9 Furnizuesi Publik me Pakice

Furnizuesi Publik me Pakice i shet energji elektrike, sipas nje kontrate me kushte dhe tarifa te rregulluara nga ERE-ja, vetem klienteve tarifore.

Furnizuesi Publik me Pakice blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumice me tarifa te miratuara nga ERE-ja.

Furnizuesi Publik me Pakice ka pergjegjesine t'i siguroje OST-se dhe Furnizuesit Publik me Shumice, grafiket e ngarkeses vjetore, mujore, javore dhe ditore ne avance ne menyre qe t'i mundesoje Furnizuesit Publik me Shumice dhe OST-se te pergatisin programet e tyre.

Furnizuesi Publik me Pakice eshte pergjegjes per reduktimin e mosarketimeve nga klientet tarifore sipas kushteve te percaktuara nga ERE-ja. ERE-ja mund te percaktojte per Furnizuesin Publik me Pakice nje tarife qe siguron incentiva per reduktimin e ketyre mos-arketimeve.

4.10 Klientët tarifore

Kliente tarifore jane ata kliente qe blejne energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Pakice me tarifa te rregulluara nga ERE-ja.

4.11 Klientët e Kualifikuar

Klientet e Kualifikuar jane kliente qe mund te blejne energji elektrike nga Furnizuesit e Kualifikuar sipas ligjit dhe procedurave te miratuara nga ERE-ja.

Çdo klient është i lirë te zgjedhe te mbetet klient tarifor apo te behet i kualifikuar nese ploteson kushtet perkatese.

ERE-ja harton regulla per te percaktuar kushtet ne te cilat nje klient mund te kthehet ne kategorine e klienteve tarifore pasi ka zgjedhur te behet klient i kualifikuar.

Klientet e Kualifikuar do t' sigurojne OST-se informacionin lidhur me ngarkesen e tyre te pritshme.

4.12 Rregullatori i Pavarur (ERE)

ERE-ja është përgjegjëse:

a) per percaktimin e te drejtave dhe detyrimeve respektive te pjesëmarrësve te tregut, sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jo diskriminuese qe sigurojne aksesin e paleve te treta;

b) per te siguruar kontroll rregullator per tregun e energjisë elektrike;

c) ne përputhje me ligjin per sektorin e energjisë elektrike, ERE-ja do t'i kerkoje te licensuarve te veprojne ne nje mënyrë te tille qe te sigurojne sigurine e furnizimit afat-shkurter dhe afat-gjate dhe te mos perfshihen ne praktika te pandershme ose te ushtrojne pushtet tregu. ERE-ja kerkon nga Furnizuesi Publik me Shumice ekzekutimin e marreveshjeve te blerjes se energjise elektrike per aq kohe sa ato kerkesa jane ne perputhje me strategjine kombetare te hartuar nga Keshilli i Ministrave dhe cdo marreveshje privatizimi.

Baza ligjore per ushtimin e këtyre pergjegjesive nga ERE-ja sigurohet nga ligji nr. 9072, date 22.05.2003 "Per Sektorine Energjisë Elektrike", i ndryshuar.

4.13 Marrëdhëniet mes pjesmarrësve te tregut

Marrëdhëniet dhe roli i pjesmarrësve te tregut ne operimin fizik te Modelit te Tregut bazohet ne kontrata dypaleshe mes pjesmarrësve te ndryshem ne përputhje me percaktimet e meposhtëme:

A) Tregu i rregulluar

1. Ndermjet KESH Gen-it dhe Furnizuesit Publik me Shumice (te pakten me qellim per berjen transparent te cmimeve qe do te vendose KESH Gen-i ndaj Furnizuesit Publik me Shumice);

2. Ndermjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice;

3. Ndermjet OST-se dhe pjestareve te tjere te tregut per transmetimin perfshire shërbimet ndihmese;

4. Ndermjet OSSH-se dhe pjestareve te tjere te tregut per shperndarjen dhe shërbimet qe lidhen me te;

5. Ndermjet PVE-ve e PPE-ve dhe Furnizuesit Publik me Shumice;

6. Ndermjet Furnizuesit Publik me Pakice dhe klienteve te tij tarifore;

7. Ndermjet KESH Gen-it dhe Tregtuesve, përfshirë kontratat e importeve, për shkëmbimet e energjisë, të cilat janë objekt i monitorimit dhe rregullave të prokurimit të ERE-s;

8. Ndermjet OST-se dhe KESH Gen-it, PVE-ve, PPE-ve dhe Tregtuesve, për humbjet e transmetimit dhe Shërbimet Ndhimese.

ERE-ja mund të miratojë marrëveshje tip ose rregulla prokurimi, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga Furnizuesit e Kualifikuar, PPE-te, PVE-te dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut kur lidhin marrëveshje dypaleshe me Furnizuesin Publik me Shumice.

B) Tregu i parregulluar

8. Ndermjet Furnizuesve të Kualifikuar dhe Klienteve të Kualifikuar;

9) Ndermjet PVE-ve, PPE-ve, Furnizuesve të Kualifikuar dhe Tregtuesve;

10) Ndermjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe PPE-ve, PVE-ve, Furnizuesve të Kualifikuar dhe Tregtuesve;

11) Ndermjet OSSH-se dhe Tregtuesve, Furnizuesve të Kualifikuar, PPE-ve dhe PVE-ve për energjinë e nevojshme për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes.

Të gjitha marrëveshjet në tregun e parregulluar janë objekt monitorimi nga ERE për të siguruar funksionimin siç duhet të tregut dhe se pjesëmarrësit e tregut nuk ushtrojnë pushtet tregu ose ndjekin praktika të pandershme. Marrëdhëniet e ndryshme kontraktuale ndërmjet OST-se, KESH Gen-it, Furnizuesit Publik me Shumice, OSSH-se, Furnizuesit Publik me Pakice, Klienteve Tarifore, Klienteve të Kualifikuar, PVE-ve, PPE-ve, Tregtuesve dhe Furnizuesve të Kualifikuar paraqiten në Shtojcat B dhe C.

Shtojca A paraqet flukset e energjisë elektrike ndërmjet subjekteve të ndryshme.

5. Karakteristikat Kryesore të Modelit të Tregut

5.1 Parashikimi Afatgjatë dhe Parashikimi Operacional

OST-ja ka për detyrë të përgatitise parashikime 15-vjeçare për nevojat e vendit për energji elektrike dhe parashikime operacionale.

- Kete parashikim OST-ja i mbështet mbi parashikimet e pjestareve të tregut;

- Furnizuesi Publik me Shumice;

- OSSH-ja dhe Furnizuesi Publik me Pakice;

- KESH Gen-i, PPE-te dhe PVE-te;

- Furnizuesit e Kualifikuar, Klientet e Kualifikuar dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut;

- Tregtuesit (përfshirë importet/eksportet);

- Si dhe parashikimet e bera nga AKBN-ja ose agjensi të tjera shtetërore të specializuara.

OST-ja është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit të siguruar nga pjestaret e tregut në ato raste kur nxjerrja e tij demton konkurrencën.

Për përmbushjen e detyrimit të saj të parashikimit OST-ja krijon një departament të vecantë parashikimi me ekspertizën e nevojshme.

5.2 Kontrata e Furnizimit të një Viti në Avance

i) Shërbime Ndhimese:

OST-ja është përgjegjëse për blerjen, nëpërmjet kontrates, të shërbimeve ndhimese, që i nevojiten sistemit në përputhje me parashikimet e mesipërme.

KESH Gen-i i ofron OST-se për të shitur shërbime ndhimese sipas marrëveshjes vjetore të shërbimeve ndhimese që negociohet midis tyre dhe miratohet nga ERE-ja.

Shërbimet ndhimese përfshijnë edhe energjinë balancuese.

OST-ja blen shërbime ndhimese shtese, në rast se këto shërbime nuk ja sigurojnë kontratat e lidhura, nga KESH Gen-i dhe nga PPE-te, Tregtuesit ose Furnizuesit e Kualifikuar për aq sa është e mundshme.

ii) Energji Elektrike:

KESH Gen-i, pasi merr në konsideratë kontratën për shërbimet ndhimese dhe energjinë për të mbuluar humbjet teknike në transmetim, i ofron Furnizuesit Publik me Shumice energji elektrike në atë sasi dhe kapacitet që kërkon, me cmime dhe kushtet të miratuara nga ERE-ja.

Kur energjia, që Furnizuesi Publik me Shumice ka blerë sipas kontratave nga KESH Gen-i, nuk është e mjaftueshme për të plotësuar nevojat me energji elektrike të Furnizuesit Publik me

Pakice, Furnizuesi Publik me Shumice mund të blejë energji shtese nga KESH Gen-i, PVE-te, PPE-te ose/dhe Tregtuesit.

5.3 Muaji ne avance

Jo më vonë se 10 dite para një muaji të caktuar në Vitin në Avance, OST-ja do të hartojë dhe publikojë një Plan Mujor Operimi për operimin e sistemit elektroenergjetik të bazuar në informacionet mujore të siguruar nga pjesëmarrësit e tregut.

Plani Mujor i Operimit për muajin në advance do të përmbajë:

- kërkesen për energji elektrike dhe mbulimin nga prodhimi vendas;
- energjinë e importuar të programuar;
- grafiket tip të ngarkesës javore dhe ditore gjatë muajit për ditët e punës, për ditët e shtuna e të djela dhe për ditët e festave, si dhe grafiku tip mujor i ngarkesës;
- verifikimin e nivelit të liqenit të Fierzes;
- planin mujor të shërbimeve të mirembajtjes dhe shërbimeve të tjera të programuara të gjeneratorëve;
- planin mujor për shërbime ndihmese;
- vlerësimin e operimeve të parashikuara në terma të qëndrueshmërisë dhe sigurisë së sistemit elektroenergjetik dhe masat e parashikuara gjatë muajit për të ruajtur sigurinë dhe qëndrueshmërinë sipas nevojës.

Për të ndihmuar OST-ne në përgatitjen e Planit Mujor të Operimit, pjesëmarrësit e tregut (KESH Gen-i, OSSH-ja, Furnizuesi Publik me Shumice, Klientët e Kualifikuar, Furnizuesit e Kualifikuar, Tregtuesit, PPE-te, etj), do t'i japin OST-se informacionin e kërkuar të specifikuar, jo më vonë se 20 dite para fillimit të muajit për të cilin është përgatitur plani.

5.4 Java ne avance

Përpara çdo jave operimi, dhe mbështetur në informacionin të siguruar nga Furnizuesi Publik me Shumice (në bashkëpunim me Furnizuesin Publik me Pakice), PPE-te, PVE-te dhe Klientet e Kualifikuar (ose Furnizuesit e Kualifikuar) duhet të përgatitë parashikimin ditor të ngarkesës për javën e ardhshme duke e përditësuar atë me OST-ne. Përpara çdo jave operimi, Furnizuesi Publik me Shumice bazuar në kontratat dypaleshe përcakton sasinë e nevojshme të energjisë elektrike që ajo do të kërkojë nga KESH Gen-i për të mbuluar ngarkesën javore.

OST-ja do të mbulojë mungesat e furnizimit të energjisë elektrike nga KESH Gen-i, PVE-te, PPE-te, Tregtuesit ose Furnizuesit e Kualifikuar nëpërmjet Shërbimeve Ndihmese, ose do të zbatojë kufizime të ngarkesës sipas seksionit 4.12 c.

5.5 Dita ne Avance dhe Axhustimet Ditore

Furnizuesi Publik me Pakice mund të rishikojë projeksionet e tij të parashikimit të ngarkesës kur nga përditësimi i ngarkesës së parashikuar janë të qarta diferencat ndërmjet energjisë së parashikuar dhe të asaj të kërkuar. Furnizuesi Publik me Pakice duhet të njoftojë OST-ne dhe Furnizuesin Publik me Shumice për rishikimin. Kur modifikimet e parashikimit justifikojnë vendimin, Furnizuesi Publik me Shumice mund të blejë energji elektrike, jashtë kontratave të mëparshme, nga KESH Gen-i me çmime të rregulluara, nga PVE-te që kanë kontrate me Furnizuesin Publik me Shumice me tarifa të përcaktuara nga ERE-ja, si dhe nga PVE-te e tjera, PPE-te dhe tregtuesit me çmime të parregulluara.

Në rast se parashikimet e përditësuara të ditës në advance tregojnë se kërkohet energji elektrike shtese nga ajo që mund të sigurohet nga të gjitha burimet e disponueshme, përfshirë PVE-te, PPE-te, Tregtuesit dhe Furnizuesit e Kualifikuar, OST-ja mund t'i imponojë OSSH-se ose Klienteve të Kualifikuar axhustime brenda ditës duke vendosur procedurë të kufizimit të ngarkesës për të mbajtur sistemin elektroenergjetik të balancuar. Në rast se parashikimet e përditësuara të ditës në advance tregojnë se kërkohet më pak energji se sa ajo që është parashikuar, OST-ja mund të imponojë axhustime për të balancuar parashikimin e ngarkesës së ditës në advance duke ulur furnizimet e blera nga PVE-te, PPE-te ose Tregtuesit.

5.6 Procedurat tipike qe ndiqen nga OST-ja

OST-ja ka pergjegjesine te dispeceroje te gjitha njesite ne zoterim te KESH Gen-it dhe te PPE-ve, te nevojshme per te mbuluar ngarkesen, si dhe ngarkesat e dispecerueshme te Klienteve te Kualifikuar, duke respektuar te gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara ne Kodin e Rrjetit per:

- a) ditën e operimit
- b) ditën pas ditës së operimit
- c) ditën e pestë pas ditës së operimit
- d) axhustimet e një dite në avance dhe brenda ditës

OST-ja do të vendose, me miratimin e ERE-s, procedura operimi që përcaktojnë afatet kohore ("gate closure") për nominimin (përcaktimin) fizik dhe rregulla të tjera që i kërkojnë OST-se për të kryer funksionet e saj të dispecerimit dhe balancimit.

OST-ja do të krahasojë shumën e parashikimeve të ngarkesës të marrë nga pjestaret e tregut me parashikimet e saj dhe të vendose se çfarë hapash të mëtejshëm (p.sh blerje) mund të jenë të nevojshme për të balancuar sistemin.

ERE-ja ka pergjegjesine, që Rregullat e Tregut të përshkruajne në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet operative që duhet të kryejë OST-ja për dispecerimin dhe të veprimtarive të tjera të përfshira në sistemin elektroenergjetik.

5.7 Shitjet e KESH Gen-it tek bleres të tjere

Marrëveshjet e furnizimit ndërmjet KESH Gen-it dhe Furnizuesit Publik me Shumice do të sigurojnë që përfitimet nga kapacitetet hidro të KESH Gen-it të jenë për Klientët Tarifore. Megjithatë, KESH Gen-i, në përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga ERE-ja mund të shesë cdo kapacitet të tij të tepert mbi sasinë e kontraktuar me Furnizuesin Publik me Shumice me çmime të parregulluara.

KESH Gen-i mund të shesë energjinë elektrike të tepert të prodhuar prej tij në tregun me çmime të parregulluara duke siguruar blerje ekonomike në përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga ERE-ja për shitjen e energjisë elektrike dhe me rregullat për eksportin e energjisë elektrike.

KESH Gen-i mund të kryejë procedurat e shitjes së energjisë elektrike me kusht që:

1. Të ketë marrë licencën përkatëse të energjisë elektrike nga ERE-ja për të shitur energji elektrike.
2. Termat e kësaj shitje, të përcaktuara nga ERE-ja në rregullat dhe procedurat e shitjes nuk do të reduktojnë përfitimet e përgjithshme të klienteve tarifore dhe nuk do të pengojnë përmbushjen e detyrimeve të KESH Gen-it sipas kontratave të tij me OST-ne dhe Furnizuesin Publik me Shumice.

KESH Gen-i do të mbajë riskun tregëtar dhe të kreditimit si pasoje e këtyre shitjeve dhe të plotësimit të detyrimit të vazhdueshëm për furnizimin me energji elektrike të OST-se dhe Furnizuesit Publik me Shumice.

Çdo fitim neto nga shitjet ose shkëmbimet e energjisë elektrike të bera nga KESH Gen-i, nëse do të ketë, do të reflektohet në përfitim të klienteve tarifore. Megjithatë, ERE-ja mund të marrë në konsideratë dhe të adoptojë mekanizma nxitese që do të vlerësohen të përshkruajen nga ana e saj, përfaqësojnë edhe lejimin e KESH Gen-it për të mbajtur një pjesë të fitimit neto nga eksporti.

6. Fluksi i Fondeve

Fluksi i fondeve në Modelin e Tregut tregohet në Shtojcën D.

Fluksi i fondeve për pjesëmarrësit Kryesorë të tregut është përmbledhur si më poshtë:

6.1 OST-ja

Të pagueshme:

OST-ja do t'i paguajë KESH Gen-it, PPE-ve, Tregtuesve dhe Furnizuesve të Kualifikuar për shërbimet ndihmëse dhe për energjinë e nevojshme për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit të blera nga ajo.

Të arkëtueshme:

a) Klientët e Kualifikuar, KESH Gen-i, Furnizuesi Publik me Pakice, PPE-të, PVE-te dhe OSSH-ja (per energjine e blere per te mbuluar humbjet) do t'i paguajnë OST-së pagesat e transmetimit (per aq sa aplikohet) të llogaritura në përputhje me tarifën që përfshihet në Marrëveshjen e Shërbimit të Transmetimit të miratuar nga ERE-ja,

b) si dhe pagesat per alokimin e kapaciteve te interkoneksionit.

Te arketueshme/Te pagueshme:

Likuidimi i pjesmarresve te tregut per disbalancat (devijimet) sipas disbalancave (devijimeve) te tyre fizike (me perjashtim te nje minimumi prej _%).

6.2 KESH Gen-i**Të pagueshme:**

KESH Gen-i do t'i paguajë OST-së (per aq sa aplikohet) për shërbimin e transmetimit te siguruar sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja;

KESH Gen-i do t'i paguajë PVE-ve, PPE-ve, Tregtuesve dhe Furnizuesve të Kualifikuar për blerjet e energjisë ekonomike (që do të thotë energji që mund të jetë e disponueshme në kohe të caktuara të ditës ose vitit e që mund të blihet më lirë nga sa mund ta prodhonte KESH Gen-i dhe që mund të përdoret ekonomikisht për nevojat e centralit ose për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale).

Të arkëtueshme:

Furnizuesi Publik me Shumice do t'i paguajë KESH Gen-it për energjinë elektrike me tarifa të rregulluara;

OST-ja do t'i paguajë KESH Gen-it per shërbimet ndihmese dhe energjine e blere per te mbuluar humbjet, ose do t'i paguaje ose marre shuma per pjesmarrjen e tyre ne tregun e rregulluar te balancimit;

OSSH, Bleresit e tregut te eksportit, Tregtuesit dhe Furnizuesit e Kualifikuar do t'i paguajnë KESH Gen-it për energjinë elektrike per aq sa do të lejohet shitja e kësaj energjie.

Humbjet në sistemin e transmetimit për shitjet e KESH Gen-it, PPE-ve dhe PVE-ve i përkasin OST-se.

Te arketueshme/Te Pagueshme:

Likuidimi i disbalances (devijimeve) te KESH Gen-it sipas disbalancave (devijimeve) fizike (me perjashtim te nje minimumi prej _%).

6.3 Furnizuesi Publik me Shumice**Të Pagueshme:**

Furnizuesi Publik me Shumice do t'i paguajë KESH Gen-it vleren për të gjithë energjinë elektrike, të cilën ajo ka blere.

Furnizuesi Pulik me Shumice do t'i paguajë PVE-ve, PPE-ve, Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtuesve vleren për energjinë elektrike që ato i kanë shitur atij.

Furnizuesi Publik me Shumice do t'i paguajë OST-së pagesat për shërbimet e ofruara nga OST-ja, përfshirë koston e shërbimeve ndihmëse, sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Të arkëtueshme:

Furnizuesi Publik me Pakice do t'i paguaje Furnizuesit Publik me Shumice vleren e energjise elektrike te livruar me tarifa te miratuara nga ERE-ja.

6.4 Operatori i Sistemit te Shpërndarjes**Të Pagueshme:**

OSSH-ja do t'i paguaje PPE-ve, PVE-ve, Furnizuesve te Kualifikuar, Tregtuesve dhe KESH Gen-it (me cmime tregu) per energjine e blere per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes.

OSSH-ja do t'i paguajë OST-së pagesat për shërbimin e transmetimit, përfshirë koston e shërbimeve ndihmëse, sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja, lidhur me energjine e blere nga OSSH-ja per te mbuluar humbjet ne sistemin e shperndarjes.

Të arkëtueshme:

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes (si Klientet Tarifore dhe Klientet e Kualifikuar të lidhur në sistemin e shpërndarjes) do t'i paguajnë OSSH-së për shërbimet e rrjetit të shpërndarjes sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Te arketueshme/Te Pagueshme:

Likuidimi i disbalances (devijimeve) të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sipas disbalancave (devijimeve) fizike (me përjashtim të një minimumi prej _%).

6.5 Furnizuesi Publik me Pakice**Të Pagueshme:**

Furnizuesi Publik me Pakice do t'i paguaje Furnizuesit Publik me Shumice për energjinë elektrike të furnizuar për Klientet Tarifore sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Furnizuesi Publik me Pakice do t'i paguajë OST-së pagesat për shërbimin e transmetimit, përfshirë koston e shërbimeve ndihmëse, sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Furnizuesi Publik me Pakice do t'i paguaje OSSH-se pagesat për shërbimin e shpërndarjes sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja.

Të arkëtueshme:

Klientët Tariforë do t'i paguajnë Furnizuesit Publik me Pakice për energjinë elektrike që u është livruar sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja. Furnizuesi Publik me Pakice do të propozojë tarifa që kanë lidhje me furnizimin e energjisë elektrike që do të rezultojnë në pagimin nga çdo Klient Tarifor brenda të njëjtes kategori klientesh net e gjithë vendin të njëjten tarife uniforme.

Te arketueshme/Te Pagueshme

Likuidimi i disbalances (devijimeve) të Furnizuesit Publik me Pakice sipas disbalancave (devijimeve) fizike (me përjashtim të një minimumi prej _%).

Fluksi i fondeve që përfshin këta dhe pjesmarrës të tjerë të tregut janë dhënë në Shtojcën D.

7. Roli i Rregullatorit të Pavarur ERE

ERE-ja e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", me të gjitha ndryshimet. Funksionimi i rregullatorit të pavarur përmbush kërkesat e Direktivës së BE-së 2003/54 dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. ERE-ja i rekomandon Qeverisë Shqiptare modelin e tregut të energjisë elektrike dhe miraton të gjitha aktet nënligjore në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Pas miratimit të Modelit të Tregut nga Qeveria Shqiptare, ERE-ja do të procedojë me reflektimin e ndryshimeve në Rregullat e Tregut, dhe në aktet e tjera nënligjore që lidhen me funksionimin e tregut.

Në përgatitjen e këtyre dokumenteve ERE-ja do të marrë në konsideratë:

a) Marrëdhëniet mes Klientit të Kualifikuar ("KK") dhe Furnizuesit Publik me Pakice e OSSH-se. Këto marrëdhënie duhen trajtuar në mënyrë specifike në Rregullat e Tregut, që do të miratohen nga ERE-ja duke marrë parasysh që:

- Një Klient i Kualifikuar nuk mund të jetë njëkohësisht dhe Klient Tarifor.

- Klienti i Kualifikuar nuk mund të blejë energji elektrike nga KESH Gen-i (me përjashtim kur lejohet në mënyrë specifike nga ERE) ose Furnizuesi Publik me Shumice.

- Rregullat e Tregut duhet të përcaktojnë qartë rrethanat dhe pagesat për rikthimin e një Klienti të Kualifikuar si Klient Tarifor në mënyrë që të mbrojnë Klientët Tariforë nga rritja e kostove të shkaktuara nga ky rikthim.

b) ERE do të hartojë dhe miratojë rregulla për menaxhimin e bllokimeve kur linjat e transmetimit janë të kufizuara dhe nuk mund t'i përballojnë të gjitha kërkesat e Klientëve Tariforë dhe atyre të Kualifikuar. ERE do të sigurojë në Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut rregulla për zbatimin e kufizimit të ngarkesave ndërmjet Klientëve Tariforë dhe Klientëve të Kualifikuar kur ka mungesë të kapaciteteve, në mënyrë që të implementohet nga OST-ja. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimet e aksesit të hapur dhe jo-diskriminues me qëllim që të plotësojnë kërkesat e BE-se për akses të hapur dhe të përputhen me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Në hartimin e këtyre rregullave, duhet kërkuar kontributi i gjithë palëve të interesuara.

c) Tepricat e energjisë elektrike në disa periudha nga vetprodhuesit që prodhojnë energji për plotësimin, tërësisht ose pjesërisht, të kërkesave të tyre për energji elektrike, të cilët do të jenë të lidhur me sistemin trajtohen si më poshtë:

Në rastet kur ekziston kapaciteti i mjaftueshëm dispeçerues, Rregullat e Tregut dhe Kodi i Transmetimit mund të sigurojnë akses në rrjet për këtë tepricë dhe ERE-ja mund të përcaktojë tarifa për blerjen e kësaj energjie që krijon përfitim për klientet.

ERE-ja gjithashtu mund të përcaktojë pagesa përkatëse për kapacitet për të mënjeluar që një klient i tillë të lejohet të shkaktojë kosto mbi Klientët Tariforë. Nëse vetprodhuesi është në pjesën më të madhe të kohës “jashtë sistemit”, por dëshiron ta përdorë sistemin si rezervë të njësisë vetë-prodhuese në rast të mirëmbajtjes ose defektit, Rregullat e Tregut mund të specifikojnë një tarifë “stand by”, e cila duhet të miratohet nga ERE-ja.

d) Në mënyrë që tregu të arrijë objektivat e tij, ERE-ja dhe, në shumë raste OST-ja, duhet të kenë akses të mjaftueshëm në informacionin lidhur me operimet, kostot, si dhe termat dhe kushtet e kontratave ndërmjet palëve. Për këtë arsye, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të dokumenteve ERE-ja duhet të sigurojë që të gjithë pjesëmarrësve të tregut do t’u kërkohej të japin të gjithë informacionin që kërkohej për kryerjen me sukses të funksioneve të ERE-s dhe OST-së, në mënyrë periodike, të plotë dhe të saktë, me kushtin e mbrojtjes së duhur nga nxjerrja e informacionit të ndjeshëm nga pikpamja e konkurrencës. Ky informacion duhet të përfshijë të paktën disponibilitetin e njësisë gjeneruese dhe përdorimin aktual, disponibilitetin e transmetimit dhe përdorimin aktual, si dhe të dhëna të tjera lidhur me prodhimin dhe çmimet. Informacioni duhet të publikohet në faqet elektronike të ERE-s dhe OST-se, për aq sa ai do të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse të konfidencialitetit.

e) Për aq sa e lejojnë rrethanat, ERE-ja duhet të rrisë efektivitetin e shfrytëzimit të sistemit elektroenergjitik nepermjet aplikimit të një sistemi tarifor të energjisë elektrike për Klientët Tariforë, e cila nxit përdorimin e energjisë elektrike natën, dekurajon përdorimin e energjisë elektrike në orët e pikut, dhe inkurajon Klientët Tariforë për zvogelimin e kapacitetit.

f) ERE-ja miraton marrveshjet e negociuara nga palët ku ndër të tjera do të përfshihen kontratat e mëposhtme:

- Marrveshja një vjeçare ndërmjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe KESH Gen-it për energjinë elektrike, përfshirë çmimin, për orë dhe sezon, për çdo njësi përkatëse gjeneruese. Marrveshjet mund të specifikojnë gjithashtu energjinë dhe kapacitetin neto vjetor që do të jetë i sigurtë (“must-run”).

- Marrveshjet dypalëshe afatgjata ndërmjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe çdo PPE-je për energjinë dhe kapacitetin neto, përfshirë çmimin për çdo orë dhe sezon.

- Marrveshjet dypalëshe afatgjata (një vjeçare ose më shumë) ndërmjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe çdo PVE-je (Gjeneruesit e Shpërndarësve) për energjinë dhe kapacitetin neto, të cilat mund të përfshijnë çmimin për çdo orë dhe sezon.

- Marrveshjet një vjeçare ndërmjet OST-se dhe KESH Gen-it për energjinë për të mbuluar humbjet në transmetim dhe shërbimet ndihmëse.

- Marrveshjet ndërmjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice për energjinë elektrike të destinuar për furnizimin e klienteve tariforë.

g) ERE-ja miraton modele marrveshjes ose kontratash për një numër kontratash ndërmjet pjesëmarrësve të tregut përfshirë:

- Marrveshjet dypalëshe për shërbimin e Shpërndarjes ndërmjet OSSH-se dhe përdoruesve të sistemit të Shpërndarjes.

- Marrveshjet e shërbimit të transmetimit midis OST dhe përdoruesve të sistemit të transmetimit.

h. Disbalancat

Shërbimi i Disbalancës së Energjisë sigurohet kur ka një diferencë ndërmjet sasisë së prodhimit që është programuar një ditë më parë ose që është prodhuar në kohë reale dhe të konsumit (ngarkesës) në kohë reale. Ai përfshin devijimet nga programet e transaksioneve dypalëshe. Ai mbulon gjithashtu flukset e paparashikuara të energjisë në sistem (për shembull nga sistemet jashtë Shqipërisë). Përderisa përdoruesit e transmetimit nuk e zgjidhin çështjen e disbalancimit nëpërmjet blerjeve të tyre, OST-ja do të bëjë blerjet e nevojshme për të siguruar që sistemi të mbetet i balancuar.

Disbalanca e Gjenerimit është diferenca ndërmjet sasise se energjisë elektrike te programuar per cdo ore, dhe sasise se energjisë elektrike te dhene nga nje burim gjenerues.

Shërbimi i Disbalancës së Gjenerimit merret kur ka një diferencë ndërmjet energjisë së programuar dhe asaj aktuale të livruar nga një burim gjenerues.

Ne percaktimin e tarifave per shërbimet e energjisë balancuese (si pjesë e sigurimit te shërbimeve ndihmese), OST-ja do te siguroje qe njesite qe krijojne disbalancen vleresohen me koston e plote te korrektimit te disbalances (perfshire koston e energjisë se blere nga OST-ja per te balancuar sistemin). Këto tarifa do te jene jo-diskriminuese dhe te bazuara ne kosto. OST-ja, gjithashtu mund te vendose me miratimin e ERE-s pagesa shtese nepermjet ndeshkimeve per devijime te perseritura te konsiderueshme nga parashikimet. Cdo e ardhur e tepert e mbledhur nga OST-ja, nga te ardhurat e kerkuara per te paguar detyrimet e shërbimeve ndihmese te saj, duhet t'u kthehen ne fund te cdo muaji pjestareve te tregut ne mënyrë proporcionale.

i) Përbushja e plotë nga të gjithë pjesmarrësit e tregut të detyrimeve të tyre kontraktuale dhe të tarifave, përfshirë pagesën e plotë për energji dhe shërbime të tjera, është e rëndësishme për suksesin e Modelit Shqiptar të Tregut. Megjithatë, mund të ketë raste, veçanërisht gjatë kohës që tregu maturohet, kur nuk do të bëhet pagesa e plotë. ERE-ja në bashkëpunim me OST-në dhe pjestarët e tregut duhet të përgatisë rregulla dhe kontrata model që rregullojnë çështjen e mospagesave apo pagesat e pjesshme. Nder te tjera, ERE-ja duhet të hartojë rregulla dhe procedura për të siguruar që autoriteti i saj rregullohet ndaj Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice të ushtrohet sipas protokollit te likujdimeve dhe te kete mundesine te ndjekë fluksin e fondeve brenda Furnizuesit Publik me Shumice dhe Furnizuesit Publik me Pakice.

8. Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë Elektrike

Qeveria Shqiptare inkurajon investimet private per ndertimin e centraleve te rinj elektrik per te plotesuar kerkesat e vendit me energji elektrike dhe per te garantuar siguri te lartë furnizimi nepermjet diversifikimit te burimeve te gjenerimit.

ERE-ja ka autoritetin te kufizojë zgjatjen e afatit te marreveshjeve afatgjata ndermjet Furnizuesit Publik me Shumice dhe PPE-ve apo furnizuesve te tjere per te shmangur efektet bllokuese ne zhvillimin e tregut per shkak te këtyre marreveshjeve.

Marreveshjet afatgjata që kanë të bëjnë me luhatjet ne çmimet e lëndës djegëse dhe në këmbimin valutor, duhen kufizur sa më shumë që të jetë e mundur.

Per te maksimizuar investimet private ne vend dhe per te zvogeluar efektet perjashtuese ne treg, rekomandohet qe Furnizuesi Publik me Shumice te bleje nga PPE-te vetem nje pjesë te prodhimit te tyre ndersa pjesa tjeter te lihet e lirë per t'u tregtuar me cmime te parregulluara brenda ose jashte vendit.

9. Procesi i Likujdimeve

Detajet e Proçesit të Likujdimeve do të specifikohen në Protokollin e Likujdimeve, si pjesë e Rregullave të Tregut të miratuara nga ERE-ja. Fondet e likujdimit duhet të perdoren sipas destinacionit per te shmangur devijimet e tyre. Proçesi duhet planifikuar që të funksionojë në mënyrë transparente, të mirëpresë përdorimin e marreveshjeve dypalëshe dhe të lehtësojë përmirësimin e nivelit të arkëtimit.

ERE-ja ka autoritet te plote te siguroje qe veprimtarite e paleve jane kryer sipas rregullave dhe protokollove dhe se këto transaksione financiare jane plotesisht transparente dhe të auditueshme.

Modeli i Tregut reflekton përpjekjet për të minimizuar rriskun e manipulimit te tregut, duke i dhënë në këtë mënyrë shitësit në treg siguri të lartë për funksionimin e tregut. Lidhjet kontraktuale

mes pjesmarrësve të tregut janë përcaktuar qartë.

Furnizuesi Publik me Shumice do të kompensojë OST-në vetëm për shërbimet e kryera prej saj dhe do të paguajë direkt Shitësin (mund të jetë KESH Gen-i, PPE-të, Furnizuesit e Kualifikuar etj.) për kostot e energjisë elektrike në përputhje me deklaratat (pasqyrat) fizike e dërguara nga OST-ja tek Furnizuesi Publik me Shumice.

Per te rritur besimin e shitesit qe pagesat do te kryhen, duhet qe:

Per tregun e rregulluar pagesat te behen direkt nga Furnizuesi Publik me Pakice, i cili është me afer burimit te fondeve per Furnizuesin Publik me Shumice, OSSH-ne dhe OST-ne;

te mos lejohet transferimi i parave cash nga Furnizuesi Publik me Pakice tek OST-ja me qellim pagimin e shitesve te tjere;

marreveshjet dhe modelet e marreveshjeve te rregulluara miratohen nga ERE-ja.

Shtojca E

Detyrat Kryesore që kërkohen për zbatimin e Modelit Shqiptar të Tregut

Institucionet dhe entet përgjegjëse të përcaktuara ne kete model tregu do te marrin masa per zbatimin ne përgjithësi te ketij modeli dhe në vecanti për:

Rishikimin dhe harmonizimin e akteve ligjore në fuqi;

Rishikimin dhe harmonizimin e Rregullave të Tregut;

Rishikimin dhe harmonizimin e Kodit të Shpërndarjes;

Rishikimin dhe harmonizimin e Kodit të Transmetimit;

Përgatitjen dhe miratimin e kontratave tip për transaksionet ndërmjet pjesmarrësve të tregut (vecanerisht per tregun e rregulluar);

Përgatitjen e rregullave dhe Protokollit te Likuidimeve për të rregulluar çështjet e mos-pagesave ose pagesave të pjesshme nga pjesmarrësit e tregut;

Pershpejtimin e reformës per ristrukturimin dhe ndarjen e veprimtarive ne sektorin elektroenergjetik;


Instalimin e matjes së duhur për të siguruar informacion të qëndrueshëm rreth të gjitha transaksioneve;

Zhvillimin dhe zbatimin e standarteve të kontabilitetit;

Përgatitjen dhe zbatimin e protokolleve të fluksit të informacionit;


Instalimin e teknologjive të informacionit që kërkohen për informacion të sigurtë të tregut;

Zhvillimin dhe miratimin e tarifave të bazuara në kosto për shërbimet e transmetimit dhe shpërndarjes.



**STRUKTURA
FLUKSI I ENERGJI**

IMPOR




STRUKTURA

MARRËVESHITET E LINJES DHE TË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT

KESH - Gen

FURNIZUE
ME SHU



**STRUKTURA
MARRËVESHJET E FURNIZIMIT**

Blerjet e Energji

KESH - Gen

Për të mbuluar humbjet

*Marrëveshja e Furnizimit me Energji për Eksportet **


Marrëveshja e Furnizimit me Energji

*Marrëveshja e Furnizimit me Energji **

OS
Operatori Sistemi

TREGJET E EN

TREGTU



STRUKTURA LIKUIDIMET – FLU

Pagesat sipas Marrëveshjes së Lidhjes

KESH - Gen

Pagesat sipas Marrëveshjeve të Furnizimit të Energjisë për Eksportet, kur lejohet nga ERE

OS
Operatori Sistemi

TREGJET E EN

Pagesat sipas Marrëveshjes së Lidhjes

Pagesat sipas Marrëveshjeve të Furnizimit të Energjisë për Eksportet, kur lejohet nga ERE

Pagesat sipas Marrëveshjeve të Transmetimit

VENDIM
Nr.407, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA QAFË MALI TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetuts, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qafë Mali të qarkut të Shkodrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 9 (nëntë) fletë, që përfundon me numrin rendor 361 (treqind e gjashtëdhjetë e një), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qafë Mali për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore:

komuna Qafë Mali

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	2	3
1-6	Pyll	Në pronësi
65,67	Pyll	Në pronësi
70-75	Pyll	Në pronësi
77-81	Pyll	Në pronësi
83-85	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
88-92	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
1-8	Pyll	Në pronësi
15-16	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
26-36	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
71-72	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
118-119	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
121	Pyll	Në pronësi
125-126	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
128-137	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
128-136	Pyll	Në pronësi
139,142,148	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
183,185,	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
220	Pyll	Në pronësi
222-223	Pyll	Në pronësi

250	Pyll	Në pronësi
253-255	Pyll	Në pronësi
269,271,273	Pyll	Në pronësi
1,4,6,9	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
11-12	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
14-20	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
60-	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
60-68	Pyll	Në pronësi
74-80	Pyll	Në pronësi
82-86	Pyll	Në pronësi
92, 100, 106	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
168-175	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
207	Pyll	Në pronësi
210-215	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
219-226	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
230-231	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
236-238	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
240-245	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
248	Pyll	Në pronësi
252, 254	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
258-259	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
264-265	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
272-273	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
275-276	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
279-280	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
289-294	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
296, 299, 300, 302	Pyll	Në pronësi
303, 3065	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
309-312	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
315	Pyll	Në pronësi
318-319	Pyll	Në pronësi
321	Pyll	Në pronësi
324	Pyll	Në pronësi
325-330	Pyll	Në pronësi
326-330	Pyll	Në pronësi
332-333	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
335-36	Pyll	Në pronësi
338-343	Pyll	Në pronësi
354-355	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
358-359	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
48-51	Pyll	Në pronësi
65-66	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
72-76	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
78-83	Pyll	Në pronësi
96-116	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
131-137	Pyll	Në pronësi
143-167	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
23-47	Pyll	Në pronësi
52-58	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
67-71	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
83-186	Pyll	Në pronësi
218-221	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi

VENDIM
Nr.408, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA RRAPE TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Rrape të qarkut të Shkodrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 5 (pesë) fletë, që përfundon me numrin rendor 222 (dyqind e njëzet e dy), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Rrape për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore:

komuna Rrape

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në Listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
2,6,	Pyll	Në pronësi
12 nën	Pyll	Në pronësi
15-16	Pyll	Në pronësi
18,22,27,29,33	Pyll	Në pronësi
36-37	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
41,46,121,125,128,135,139,141,143	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
146-151	Pyll	Në pronësi
187-188	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
190,194,201	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
198-199	Pyll	Në pronësi
211,214, 216, 219,223,230,233	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
235	Pyll	Në pronësi
237-243	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
245-246	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
248-264	Pyll	Në pronësi
268-269	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
272-274	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
1-8	Pyll	Në pronësi
12-67	Pyll	Në pronësi

5,7,10,14, 16	Pyll	Në pronësi
18-19	Pyll	Në pronësi
21,32,38,46,50,53,55	Pyll	Në pronësi
61-67	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
2,9,10,15,20, 22	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
24-25	Pyll	Në pronësi
27-30	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
32-33	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
33,39,41,43, 48	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
50-67	Pyll	Në pronësi
73-76	Pyll	Në pronësi
91,108, 260,264, 266,284	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
42-70	Pyll	Në pronësi
78-79	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
81-87	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
89,91	Pyll	Në pronësi
95-96	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
98-99	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
10-106	Pyll	Në pronësi

VENDIM
Nr.409, datë 8.4.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA VAU I DEJËS TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Vau i Dejës të qarkut të Shkodrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 4 (katër) fletë, që përfundon me numrin rendor 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Vau i Dejës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
353-384	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
392-397	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
402-429	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
431-438	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
441-478	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
489-525	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi

VENDIM**Nr.410, datë 8.4.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA ZHARRËZ TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Zharrëz të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 10 (dhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Zharrëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Sali Berisha**

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit te pronës	Lloji i transferimit
65-74	Pyll + kullotë	Pronësi

VENDIM
Nr.411, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA ARANITAS TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Aranitas të qarkut të Fierit, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 3 (tre) fletë, që përfundon me numrin rendor 98 (nëntëdhjetë e tetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Aranitas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Aranitas

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
49-146	Pyll	Pronësi

VENDIM
Nr.412, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA LEKAS TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Lekas të qarkut të Korçës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 20 (njëzet), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Lekas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore

komuna Lekas

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
276;284;286;288;313;344;	Pyje	Në pronësi
352-355;357-358;374-375	Pyje	Në pronësi
377-379;382;384;388	Pyje	Në pronësi

VENDIM
Nr.413, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA GORË, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gorë, të qarkut të Korçës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 5 (pesë) fletë, që përfundon me numrin rendor 176 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Gorë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
202-205;213-219;305-316;327	Pyje	Në pronësi
330-334;425-447;470;477;479-485	Pyje	Në pronësi
487-488;491-501;508-591;596-614	Pyje	Në pronësi

VENDIM
Nr.414, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA LIBONIK, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Libonik, të qarkut të Korçës, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 2 (dy) fletë, që përfundon me numrin rendor 36 (tridhjetë e gjashtë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Libonik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Libonik

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listen e inventarit	Fusha e përdorimit te pronës	Lloji i transferimit
420; 424-429; 431-438;	Pyje	Në pronësi
440-441; 443-461	Pyje	Në pronësi

VENDIM
Nr.415, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA ÇEPAN, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Çepan, të qarkut të Beratit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 6 (gjashtë) fletë, që përfundon me numrin rendor 240 (dyqind e dyzet), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Çepan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njesia e Qeverisjes vendore:	Komuna Çepan	Lidhja 1
Numrat rendore te pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
200-439	Pyll, kullote dhe sipërfaqe te tjera	Në pronesi

VENDIM
Nr.416, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA ROSHIK, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që

janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Roshnik, të qarkut të Beratit, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 6 (gjashtë) fletë, që përfundon me numrin rendor 249 (dyqind e dyzet e nëntë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Roshnik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Roshnik

Lidhja 1

Nr	Numri rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	96	Shkembore	Në pronësi
2	98	Shkembore	Në pronësi
3	103-118	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
4	123-124	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
5	127-134	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
6	136	Kullote	Në pronësi
7	138-148	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
8	150	Boshe	Në pronësi
9	153	Pyll	Në pronësi
10	157	Pyll	Në pronësi
11	159-160	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
12	162	Pyll	Në pronësi
13	164	Pyll	Ne pronesi
14	165	Pyll	Në pronësi
15	169	Boshe	Në pronësi
16	172-176	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
17	178-182	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
18	184	Pyll	Në pronësi
19	190-205	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
20	209-275	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
21	287-295	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
22	298	Pyll	Në pronësi
23	323-328	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
24	331	Boshe	Në pronësi
25	333	Boshe	Në pronësi
26	335-337	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
27	339	Boshe	Në pronësi
28	343	Shkembore	Në pronësi
29	371-379	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
30	382	Shkembore	Në pronësi
31	395	Pyll	Në pronësi
32	396	Boshe	Në pronësi
33	387-446	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
34	450	Kullote	Në pronësi

35	454-455	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
36	457-499	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi

VENDIM
Nr.417, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA VERTOP, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Vertop, të qarkut të Beratit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 6 (gjashtë) fletë, që përfundon me numrin rendor 224 (dyqind e njëzet e katër), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Vertop për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Vertop

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
171-186	Pyll+ sip të tjera	Në pronësi
188	Siperf. Boshe	Në pronësi
194-301	Pyll+ të tjera	Në pronësi
306	Siperf. Boshe	Në pronësi
308-337	Pyll+ të tjera	Në pronësi
339	Pyll	Në pronësi
340	Sip e roduar	Në pronësi
344-346	Pyll	Në pronësi
350-358	Pyll+ të tjera	Në pronësi
360-376	Pyll+ të tjera	Në pronësi
378	Pyll	Në pronësi
380-382	Pyll+ të tjera	Në pronësi
430	Sip boshe	Në pronësi
434-436	Pyll+ të tjera	Në pronësi
439-455	Pyll+ të tjera	Në pronësi

470-478	Pyll+ të tjera	Në pronesi
480-481	Pyll+ të tjera	Në pronesi
550-562	Pyll+ të tjera	Në pronesi
594-633	Pyll+ të tjera	Në pronesi
657-676	Pyll+ të tjera	Në pronesi
693-698	Pyll+ të tjera	Në pronesi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 21.4.2008
Doli nga shtypi më 23.4.2008

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë